



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE

VENDIM

Nr 19 Datë 29 / 1 / 2026

Për emërimin dhe miratimin e skemes të shpërblimeve të Audituesëve Ligjorë për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2025 të Qendra Sportive Korçë sh.a

Bazuar në nenin 135 pika 2 gërma (ç) të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, i ndryshuar dhe gërma (d) për miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në gërmat "c" e "ç" të kësaj pike, ligjit 10 091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, ligjit Nr. 47/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 10 091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe Kontabilistit të Miratuar” të ndryshuar, në Statutin dhe Aktin e themelimit të shoqërisë “Qendra Sportive Korçë” sh.a Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve:

**VENDOSI**

1. Të emërojë ekspert kontabël të autorizuar Z/Znj. Anila Gunohi me nr personal H154220118 dhe Z/Znj. Ilida Ikononi me nr personal H152201906.
2. Të miratojë skemën e shpërblimeve të ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2025 të Qendra Sportive Korçë sh.a në shumën 270,000 lekë pa TVSH
3. Për regjistrimin e këtij vendimi në QKB ngarkohen administratoret e shoqërisë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen ekspertët e shoqërisë të emëruar sipas pikes 1.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

6. Miratuar me 24 vota
7. Vota Pro 24
8. Vota Kundër 1
9. Vota Abstenim 0
10. Zbardhur më datë 29-1-2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA SPORTIVE KORÇË sh.a

Nr 14 Prot

Datë 12/01/2026

## KËRKESË

**Drejtuar:** Asamblesë të Përgjithshme të Aksionerëve të Qendra Sportive Korçë sh.a

**Lënda:** Thirtja e Asamblesë të Përgjithshme të Aksionerëve nga Qendra Sportive Korçë sh.a

Të nderuar përfaqësues të Asamblesë, nën cilësinë e Administratorit të Qendra Sportive Korçë sh.a, kërkoj mbledhjen e Asamblesë të Përgjithshme të Aksionerëve për shqyrtimin dhe miratimin e dy materialeve të përgatitur dhe dërguar secilit prej jush në formë elektronike, për mbledhjen e muajit Janar të Këshillit Bashkiak.

Ju lutemi ta merrni parasysh kërkesën, shqyrtimin e materialeve dhe miratimin e tyre në mbledhjen e radhës.

- 1. Për emërimin dhe miratimin e skemes të shpërblimeve të ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2025 të Qendra Sportive Korçë sh.a**
- 2. Për miratimin e trajtimit ushqimor dhe dietave për Ekipin e Përfaqësues dhe Akademinë "Skenderbeu" për vitin 2026**

Faleminderit

ADMINISTRATORI

Luis QIRINXHI

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKQYRËS

Kletjon KFTA



BASHKIA KORÇE  
NR 520 PROT  
DATA 19/01/2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA SPORTIVE KORÇË sh.a

RELACION

Datë 12/01/2026

Për emërimin dhe miratimin e skemes të shpërblimeve të Audituesëve Ligjorë për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2025 të Qendra Sportive Korçë sh.a

Bazuar në nenin 135 pika 2 gërma (ç) të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, i ndryshuar dhe gërma (d) për miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në gërmat "c" e "ç" të kësaj pike, ligjit 10 091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe Kontabilistit të Miratuar”, ligjit Nr. 47/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 10 091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe Kontabilistit të Miratuar” të ndryshuar, në Statutin dhe Aktin e themelimit të shoqërisë “Qendra Sportive Korçë” sh.a i kërkoj Asamblesë të Përgjithshme të Aksionerëve të propozojë dhe të emërojë Audituesit Ligjor, si dhe të miratojë skemën e shpërblimeve të këtyre Audituesëve për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2025 të Qendra Sportive Korçë sh.a, duke u mbështetur në tabelën me treguesit lidhur me afatet kohore të auditimit ligjor të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të Institutit të Ekspertëve Kontabël Të Autorizuar me Vendimin nr. 163 datë 01.07.2024 dhe Tab.1.1

Tab1.1

<b>Totali i Aktivit me të ardhurat</b>	<b>Niveli referues</b>
Deri në 15 milion lekë	60 orë pune
150 - 500 milion lekë	60 - 90 orë pune
500 milion - 1 miliard lekë	90 - 120 orë pune
1 - 2 miliard lekë	120 - 180 orë pune

Shënim: Të ardhurat e “Qendra Sportive Korçë” sh.a për vitin 2025 janë: 5,504,336 lekë

Subvencione Bashkia Korçë: 74,941,139 lekë

Aktive: 509,493,784 lekë

**Totali i Aktivit me të ardhurat : 589,939,259 Lekë**

si dhe në bazë të vendimit të Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar datë 29.06.2011 i cili ka miratuar një tarifë normale orare për kryrjen e auditimit ligjor prej 3000 lekë/orë.

Shoqëria do të paguajë Ekspertët Kontabël të Regjistruara për misionin që do të kryejnë si më poshtë:

Orë pune 90 x 3,000 lekë/orë = 270,000 lekë

**Në shumën e mësipërme nuk është përfshirë TVSH-ja.**

Faleminderit

**ADMINISTRATORI**

**Luis QIRINXHI**